

---

# Siguria e Energjisë Përtej Qymyrit

---

ANALIZË E POLITIKAVE

---

/2019



# Siguria e Energjisë Përtej Qymyrit

---

Autor: **Dardan Abazi**

**Burim Ejupi**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Qershor, 2019**

Foto e ballinës: **Getty Image**

ISPN: **F3824284234**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockfeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

---

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	4
Metodologjia.....	5
Baza ligjore dhe institucionale.....	5
Mungesa e konsistenës dhe qartësisë.....	6
Adekuacia e sistemit .....	7
Izolimi në qymyr apo Integrimi rajonal .....	7
Bashkimi kombëtar energjetik dhe Integrimi rajonal .....	8
Më shumë prodhim, më shumë siguri .....	10
Potencialet .....	10
Përfundime.....	13
Rekomandime.....	14

## Hyrje

Në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026 përmendet fakti qysh “Kosova asnjëherë nuk mund të mbërrijë përmbushjen e kërkesës për energji”.<sup>1</sup> Për të mbërritur këtë “siguri të furnizimit”, Strategjia është e orientuar pothuajë ekzkluzivisht në arritjen e saj përmes ndërtimit të një termocentrali të ri me qymyr. E gjithë kjo, është e fokusuar kryesisht nga të kuptuarit e ngushtë të termit “siguri e energjisë”.

Siguria e energjisë është përmendur si njëra nga problematikat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit. Në paraqitje publike, përkrahësit e ndërtimit të një termocentrali të ri me qymyr, gjithnjë kanë potencuar faktin se bizneset e Kosovës humbin 300 milion euro në vit nga mungesa e energjisë elektrike.<sup>2</sup> Ky qëndrim, që mbështetet në një studim të kryer e i cili asnjëherë s’është bërë publik.

Por shifrat e shpenzimit të energjisë elektrike e thonë të kundërtën. Niveli i prodhimit të energjisë elektrike në vend tejkalon shifrat e pamjaftueshmërisë vetëm në muajt e dimrit. Importi i realizuar për vitin 2018 ka qenë 825,182 MWh, me të cilin janë plotësuar mungesat e energjisë sidomos kohën e pikut në sezonin e dimrit kur kërkesa ishte e papërbalueshme për prodhimin vendor.<sup>3</sup> Ky import i rrymës është bërë kryesisht pra në muajt e dimrit ku kërkesa për energji është më e madhe.




Figura 1. Importi dhe Eksporti i Energjisë Elektrike për vitin 2018. BURIMI: ZRRE

<sup>1</sup>Republika e Kosovës, (2017), Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, Prishtinë: GZRKS.

<sup>2</sup> Insajderi, (2017), Bizneset Humbin Rreth 300 Milionë Euro- Shkaku i Rrymës, Prishtinë: Insajderi.

<sup>3</sup>Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raporti Vjetor për vitin 2018, Importi dhe Eksporti i Energjisë Elektrike, faqe 104, Prishtinë: ZRRE.

Gjithsej importi i energjisë elektrike për vitin 2018 ka qenë 825,182 MWh, e që është rreth 31 pikë përqindje më i ulët se sa në vitin 2017 që ishte 1,242,225 MWh.<sup>4</sup> Pra, megjithë faktin se një pjesë e energjisë është dashur të importohet për disa nga muajt e dimrit, trendi i importit është në rënje. Sic shihet edhe në grafikun më poshtë, importi ndër vite ka shënuar rënje.

## **Metodologjia**

Metodologjia për hartimin e këtij punimi ka qenë kryesisht kualitative. Të dhënat sekondare të mbledhura nga hulumtimi në tavolinë janë analizuar përmes metodës së analizës së përmbajtjes. Përgjat hartimit të këtij punimi, ne nuk kemi kufizuar në qasje duke përfshirë qasjen kranasuese, historike dhe të zgjedhjes racionale. Të gjitha këto, na kanë ndihmuar

Në pjesën e mbledhjes së të dhënave në tavolinë, të dhënat e mbledhura kanë përfshirë: dokumente të Qeverisë dhe dokumente të Zyrës së Rregullatorit për Energji, të dhëna të paraqitura nga Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT), të dhëna të Agjencisë së Statistikave, raporte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare etj. Përveç këtyre, ne kemi trajtuar edhe deklaratat publike dhe kemi bërë një analizë të diskursit publik në përgjithësi.

Të gjithë dokumentat e mbledhura, ne i kemi analizuar përmes metodës së analizës së përmbajtjes. Përmes kësaj, ne kemi arritur jo vetëm të identifikonim të dhënat e nevojshme, por edhe të ndërtonim një analizë sa më të saktë të impaktit të tyre dhe lidhshmërisë që kishin me subjektin e analizës sonë. Në fund, përfundimet dhe argumentet e analizës i janë nënshtuar edhe një testi logjik për të parë nëse ato përkonin edhe me kontekstin e tanishëm të zhvillimit të Kosovës.

## **Baza ligjore dhe institucionale**

Baza ligjore dhe institucionale është e vendosur në masë të kënaqshme. Përveç Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që është institucioni ombrellë për hartimin e politikave, institucione të tjera përfshijnë edhe Zyrën e Rregullatorit për Energji si institucion i pavarur që rregullon (dhe derregullon), tregun e energjisë në Kosovë. Përveç këtyre, në treg operojnë edhe kompani të licencuara siç janë Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT) që është në pronësi publike, Operatori i Shpërndarjes që është në pronësi private, furnizuesit dhe prodhuesit e licencuar.

Baza ligjore dhe institucionale në Kosovë lëngon më së shumti nga mungesa e qartësisë së prioritetëve, mungesa e pavarësisë së institucioneve dhe mungesa e konsistencës në politikëbërje. Të gjitha këto sfida kanë bërë që në pjesën e sigurisë së furnizimit, Kosova të qalojë

Në pjesën e mungesës së qartësisë së prioritetëve që në Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë, siguria e Energjisë është kufizuar vetëm në sigurinë e furnizimit dhe atë është definuar si: “mundësia e sistemeve të energjisë për t’i furnizuar konsumatorët fundorë me sasi adekuate të energjisë, në

---

<sup>4</sup>Ibid.

mënyrë që t'i përmbushin nevojat e tyre".<sup>5</sup> Ky përkufizim është jashtëzakonisht i gjerë dhe nuk përfshinë atë që vërtetë mund ta quajmë siguri të furnizimit.

Siguria e energjisë përfshinë shumë më tepër sesa siguria e furnizimit. Ajo ndërlihet edhe me kualitetin e shërbimit që drejtëpërdrejtë afekton të drejtat e konsumatorëve por edhe me përballueshmërinë e çmimeve.<sup>6</sup> Në fakt, në konceptin e sigurisë së energjisë marrë në konsideratë edhe legjislacionin evropian në këtë fushë, këto janë elementet kryesore të sigurisë së furnizimit:

- Siguria e furnizimit
- Mbrojtja e konsumatorit
- Përballueshmëria e çmimeve

Ndërkohë që Kosova ka marrë për bazë vetëm elementin e parë që ka të bëjë me sigurinë e furnizimit, në legjislacionin tonë, fatkeqësisht mungon përfshirja e elementeve të tjera në atë që përbën sigurinë e furnizimit.

Në pjesën e bazës ligjore, një element që është mjaft relevant edhe për fushën e sigurisë së energjisë është edhe pavarësia e institucioneve. Institucionet e Kosovës ende nuk kanë arritur që të krijojnë mekanizma rregullatorë të pavarur. Zyra e Rregullatorit për Energji ende është skajshmërisht e ndikuar politikisht dhe të gjitha vendimet, përfshirë vendimet për hapjen dhe liberalizimin e tregut, kanë prevalencë të ndikohen politikisht. Vendime të tilla kanë të bëjnë edhe me rastet e mbrojtjes së konsumatorit, të integritimit të tregut etj. Që të gjitha këto vendime kanë ndikim të lartë politik dhe jo gjithmonë janë marrë bazuar në ekspertizë dhe pa ndikim politik.

## Mungesa e konsistenës dhe qartësisë

Një nga problemet bazë të politikës vendore në fushën e energjisë në përgjithësi dhe sigurisë së energjisë në veçanti është edhe mungesa e konsistencës në qëndrime. Në njërën anë, në dhjetor 2017, Ministri i Zhvillimit Ekonomik nënshkruan kontratë 1.3 miliardë euro për investime në termocentral me qymyr, e në anën tjetër, një muaj më vonë shpallë vitin 2018 si vit të energjisë nga burimet e ripëtrishme.

<p><b>Raporti Vjetor i ZRRE-së për vitin 2018</b> (mars, 2019)</p>	<p><b>Dokumenti i propozuar për Vendosjen e Obligimit të Shërbimit Publik për Siguri të Furnizimit (Vendosja e taksës për Siguri të Furnizimit)</b> (shkurt, 2019)</p>
<p>Në pjesën e adekuacisë së gjenerimit në faqe 76, ZRRE thekson: Adekuacia e gjenerimit dhe siguria e furnizimit në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, <b>janë në nivel të pranueshëm dhe vlen të theksohet se gjenerimi i energjisë elektrike së bashku</b></p>	<p>ZRRE-ja mendon se ekziston një problem i adekuacisë së gjenerimit i cili është duke vazhduar dhe do të vazhdoj deri në vitin 2026.</p>

<sup>5</sup>Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. Xx/l-XX për Energjinë, Prishtinë: GZRKS.

<sup>6</sup>Footnote.

<b>me importin plotësojnë konsumin nacional të energjisë elektrike.</b>	
---	--

Siç shihet nga tabela e mësipërme, Zyra e Rregullatorit për Eenergji ka dy qëndrime krejtësisht të kundërta në vetëm një muaj sa i takon adekuacisë së gjenerimit. Në raportin në të cilin tentohet të vihet taksë për sigurinë e furnizimit fillimisht theksohet se ZRRE mendon se do të ketë një problem me adekuacinë e gjenerimit. Në anën tjetër, për shumë pak javë, në Raportin Vjetor për vitin 2018, ZRRE thekson se adekuacia e gjenerimit dhe siguria e furnizimit në sistemin elektroenergjetik të Kosovës janë në nivel të pranueshëm. Pra, për të njëjtën çështje, jepen dy qëndrime krejtësisht të ndryshme varësisht se në çfarë dokumenti publikohet ky çëndrim.

## **Adekuacia e sistemit**

Adekuacia e gjenerimit dhe siguria e furnizimit në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, janë në nivel të pranueshëm dhe vlen të theksohet se gjenerimi i energjisë elektrike së bashku me importin plotësojnë konsumin nacional të energjisë elektrike.

Adekuacia e sistemit të transmetimit përmban rezerva të mjaftueshme për të mundësuar rrjedha të energjisë elektrike për plotësimin e kërkesës vendore, përshirë edhe mbulimin e ngarkesës maksimale (pikut), si dhe për të mundësuar transit nëpër linjat interkonektive.

Kapaciteti i përgjithshëm operativ i gjeneratorëve në Kosovë është 1076 MW, derisa ngarkesa maksimale gjatë këtij viti ka qenë 1,203 MW, andaj raporti i adekuacisë së gjenerimit ndaj ngarkesës maksimale është 89.4 %.<sup>7</sup>Kjo përqindje, konsiderohet e kënaqshme marrë parasysh se pra, Kosova nuk mbulon vetëm 11.6% të kërkesës bazuar në kapacitetin operativ të gjeneratorëve.

## **Izolimi në qymyr apo Integrimi rajonal**

Një nga problemet kryesore të rritjes së sigurisë së furnizimit është projektimi i tregut të Kosovës si treg i izoluar dhe i pa integruar. Në strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës thuhet:


Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar në zbatimin e të gjitha obligimeve të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe MSA-së, për krijimin e tregut të lirë dhe konkurrues të energjisë. Qeveria e ka vendosur si prioritet krijimin e një zone të përbashkët tregtare energjetike Kosovë-Shqipëri, si hap të parë drejt integrimit në tregun rajonal të energjisë.<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup>Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raporti Vjetor për vitin 2018, Prishtinë: ZRRE.

<sup>8</sup>Republika e Kosovës, (2016), Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, Prishtinë: MZHE.

Megjithatë, prioritet kryesor i strategjisë është furnizimi i rregullt përmes ndërtimit të një termocentrali të ri. Kjo strategji, analizon tre skenarë për kërkesën për energji me anë të së cilëve vjen në përfundimin se ndërtimi i termocentralit Kosova e Re është i domosdoshëm.



Kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në sistem në vitin 2018 ka qenë 5,671 GWh që është më e ultë sesa skenari i ultë i projektuar nga MZHE në këtë strategji. Kjo tregon që ideja kryesore nuk ka qenë ofrimi i një strategjie që ndihmon në rritjen e sigurisë së energjisë, por për të arsyetuar ndërtimin e një termocentrali të ri me bazë në qymyr.

## Bashkimi kombëtar energjetik dhe Integrimi rajonal

Bashkimi kombëtar energjetik, që do të nënkuptonte një bashkim të tregut të energjisë së Republikës së Kosovës me atë të Shqipërisë është parë si hapi i parë drejt integritit të tregut me rajonin. Në diskursin publik, bashkimi energjetik me Shqipërinë nënkupton më shumë siguri të furnizimit sepse këto dy tregje shihen si komplementare për njëra tjetrën.

Meqë Shqipëria furnizohet në një pjesë të konsiderueshme me energji hidrike, potencialet e saj natyrshëm rriten gjatë dimrit. Në anën tjetër, kërkesa për energji në Kosovë rritet pikërisht në muajt e dimrit dhe kështu, bashkimi kombëtar do të zgjidhte problemet sepse energjinë tepërcë që Shqipëria e ka gjatë dimrit do t'ja ipte Kosovës dhe anasjelltas. Megjithatë, a është kjo e vërtetë apo më tepër një mit?

Për balancim dhe stabilitet të sistemit energjetik, aktualisht përdoren rezervat e energjisë si mekanizma me anë të së cilave sigurohet se oferta për energji mbulon kërkesat si dhe kërkesat për



energji nuk janë më të vogla sesa ofertat. Të gjithë këta mekanizma aktivizohen për të ruajtur frekuencën prej 50 herc (Hz) e cila mbërrihet kur këto të dyja, prodhimi dhe kërkesa për energji janë të barabarta dhe sistemi është i balancuar.

Rezervat ndahen në rezerva primare, sekondare dhe terciare. Rezerva primare është e decentralizuar. Kjo nënkupton se ajo aktivizohet në momentin që sistemi disbalancohet qoftë edhe për 0.5 Hz. Kjo rezervë praktikisht ndodhet në secilin gjeneratorë i cili rritë kapacitetin prodhues ose e zvogëlon atë me automatizëm kur kjo kërkohet për balancim të sistemit.

Nëse sistemi nuk balançohet as pas aktivizimit të rezervës primare, ose thënë më shkurt, nëse edhe pas reagimit të gjeneratorëve (rezerva primare), nuk arrihet balancimi i sistemit, atëherë aktivizohet rezerva sekondare. Kjo rezervë është në vlerë prej 20 MW. Operatori ynë i sistemit të transmisionit nuk është përgjegjës për rezervën sekondare dhe terciare marrë parasysh faktin se këto rezerva janë përgjegjësi e zonës rregulluese e që ende është nën përgjegjësinë e Serbisë.

Rezerva terciare është rezerva më e madhe në kapacitet dhe vihet në funksion nëse as pas aktivizimit të rezervës sekondare nuk është arritur balancimi i sistemit. Rezerva terciare ka vlerën e kapacitetit të instaluar të gjeneratorit më të madh në një sistem energjetik. Në rastin e Kosovës, kjo rezervë është në vlerë prej 160 MW. Kjo rezervë mbahet dhe paguhet nga shtetet në rast të dështimit të rezervës primare dhe sekondare për të balancuar sistemin.

Por përse kanë rëndësi të madhe rezervat në rritjen e sigurisë së energjisë dhe cili është ndikimi i tyre në konceptimin e sigurisë? Siç e shpjeguam më sipër, një rregull mjaft i thjeshtë vlenë për rezervën terciare: ajo duhet të jetë e barasvlefshme me vlerën e kapacitetit instalues të gjeneratorit më të madh në një sistem energjetik. Pra, sa më i madh sistemi, aq më e vogël nevoja e njërive të këtij sistemi për të pasur rezervën terciare. Dy shtete që bashkojnë tregun nuk kanë nevojë të mbajnë dy rezerva: ato mbajnë një rezervë të përbashkët. Përveç që kursehen shumë para, kjo praktikë rezulton me më shumë siguri të furnizimit për shtetet.

Integrimi rajonal rritë edhe luhatjet e energjisë që mundësojnë mitigim të kostove të disbalancit. Kjo për Kosovën është mjaft e rëndësishme pikërisht sepse hapen dyert për më shumë integrim të energjisë së ripëtrishme në treg. Në këtë mënyrë, ulët kostoja e disbalancit dhe sa më i madh sistemi, aq më e lehtë balancimi i tij.

Integrimi rajonal dhe siguria e furnizimit kanë sfidat e tyre. Sfidë kryesore mbetet krijimi dhe rritja e besimit të vendeve të rajonit për të bashkëpunuar në një projekt aq të madh siç është integrimi. Shtetet e Ballkanit perëndimor, të dala nga lufta ende nuk i kanë tejkaluar ndasitë në mes tyre. Si rrjedhojë problemet politike kanë ndikuar që Qeveritë e këtyre vendeve të insistojnë që të vetëmjaftohen me energji. Për më tepër, investimi në qymyr është parë si një investim strategjik me rëndësi të jashtëzakonshme edhe për sigurinë kombëtare.

## Më shumë prodhim, më shumë siguri




Figure 1. Adekuacia e projektuar për Kosovën. Burimi: SEERMAP, REKK

Sipas modelimit të SEERMAP, adekuacia e gjenerimit është negative nga viti 2025 në skenarin e dekarbonizimit kurse në skenarin referent dhe të atij të jo masave, adekuacia e gjenerimit mbetet positive. Sidoqoftë, adekuacia e sistemit është positive për të gjithë periudhën edhe me skenarin e dekarbonizimit të plotë.<sup>9</sup>

### Potencialet

Gjatësia e përgjithshme e linjave të transmetimit që menaxhohen nga KOSTT sh.a është 1391.3 km

- linja 400kV – 279.7 km
- linja 220kV – 231.8 km
- linja 110kV – 873.1 km.

Nënstacione

<sup>9</sup> SEERMAP, (2017), Kosovo Report, i qasshëm në [https://rekk.hu/downloads/projects/SEERMAP\\_CR\\_KOSOVO\\_A4\\_ONLINE.pdf](https://rekk.hu/downloads/projects/SEERMAP_CR_KOSOVO_A4_ONLINE.pdf) (qasur në maj 2019).

- 1 Nënstacion 400/220 kV me kapacitet të transformatorëve 1200 MVA
- 2 Nënstacion 400/110 kV me kapacitet të transformatorëve 1200 MVA
- 3 Nënstacione 220/110 kV me kapacitet të transformatorëve 1350 MVA
- 1 Nyje shpërndarës 220 kV
- 1 Nënstacion 220/35/10 kV me kapacitet të transformatorëve 80 MVA
- 28 Nënstacione 110/(35 ose 10) kV me kapacitet transformatorëve 2080 MVA

Kapacitetet bartëse të transmisionit : 1700 MW


Falë pozitës qendrore gjeografike që ka shteti ynë, sistemi i transmisionit me të cilin operon KOSTT, edhe pse i vogël, paraqet një nyje shumë të rëndësishme të transmisionit në Evropën Juglindore

Linjat interkonektive në Sistemin Transmetues të Kosovës

- 1 linjë 400 kV Kosovë - Serbi
- 1 linjë 400 kV Kosovë - Malin e Zi
- 1 linjë 400 kV Kosovë – Maqedoninë
- 1 linjë 400 kV Kosovë – Shqipëri
- 1 linjë 220 kV Kosovë - Serbi
- 1 linjë 220 kV Kosovë – Shqipëri
- 2 linja 110 kV Kosovë - Serbi<sup>10</sup>

---

<sup>10</sup> Ueb faqja zyrtare e Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit, (2019), Kapacitetet e sistemit të transmetimit, Prishtinë: KOSTT



Operimi i Sistemit kryen proceset e planifikimit afatmesëm dhe afatshkurtër, analizat e operimit të sistemit, monitorimin dhe kontrollimin e rrjedhave të fuqisë në SEE të Kosovës. I tërë ky proces bëhet me qëllim të operimit të sigurtë dhe të besueshëm të sistemit vazhdimisht 24 orë gjatë 365 ditëve.<sup>11</sup> Operatori i Sistemit, nëpërmjet planifikimit dhe operimit siguron që në vazhdimësi të realizohet furnizim kualitativ i konsumatorëve, me parametra teknik si tension dhe frekuencë, në përputhje me kodet teknike në fuqi. Poashtu, gjatë gjithë kohës siguron punën sinkrone me TSO-të tjera, si dhe ofron shërbimet e sistemit.

Me qëllim të krijimit të kushteve për tregun e energjisë elektrike, OS kryen kalkulimet e kapaciteteve transmetuese interkonektive në disponim. Nga Qendra Nacionale Dispečerike monitorohen dhe kontrollohen rrjedhat e fuqisë nëpër rrjetin transmetues të Kosovës, duke dhënë instruksionet e nevojshme palëve të treta të kyçura në SEE të Kosovës.

Meqenëse energjia elektrike nuk ka mundësi deponimi, pra prodhimi duhet të jetë i barabartë me ngarkesën, OS nëpërmjet mekanizmave të balancimit në disponim, i mban parametrat teknik në kufijtë e operimit të sigurtë. Për këtë qëllim përdoren shërbimet ndihmëse të nevojshme, si rezerva primare, sekondare dhe terciare. Këto shërbime i mundësojnë palëve në treg, siç janë gjenerimi

<sup>11</sup> KOSTT(2019), Operimi i Sistemit Energjetik, Prishtinë: Ueb faqja e KOSTT.

dhe distribucioni, që të zhvillojnë operimet e tyre në mënyrë sa më të besueshme, në aspektin teknik dhe ekonomik.

KOSTT në baza vjetore bën përpilimin e parashikimit të bilansit elektroenergjetik njëvjeçar, dhe planifikimin afatgjatë për zgjerimin e rrjetit transmetues.

Me qëllim të mbajtjes së një furnizimi kualitativ të konsumatorëve, Qendra Dispeçerikne Nacionale koordinon mirëmbajtjen, në aspektin e planifikimit dhe implementimit në kohë reale, për pjesën e rrjetit në SEE të Kosovës.

Operimi i sistemit bazohet në tri objektiva kryesore:

- Të mundësojë operim të sigurtë dhe me besueshmëri të lartë të sistemit elektroenergjetik
- Të mundësojë operimin ekonomik të sistemit dhe të mundësojë tërësinë e energjisë
- Të mundësojë aranzhimet kontraktuale sipas programit D-1<sup>12</sup>

Operimi i sistemit duhet të garantojë punë të sigurtë me besueshmëri të lartë të sistemit duke kontrolluar zhvillimet e mundëshme në sistem dhe veprimet në sistem përballë kontigjencave të ndryshme siç janë: lidhjet e shkurtëra, ndryshimet e papritura të ngarkesës, rënja e gjeneratorit nga puna etj. Nëpërmjet monitorimit të punës si dhe kontrollit të sistemit bëhet i mundur parashikimi i riskut, me qëllim që të ndërmerren masat efektive preventive për të minimizuar zgjerimin e ndodhive ashtu që sistemi mos të degradojë deri në rënje totale (black out).

## **Përfundime**

Siguria e energjisë është një koncept shumëdimensional dhe që nuk përfshin vetëm sigurinë e furnizimit por edhe sigurinë e furnizimit, mbrojtja e konsumatorëve dhe përballueshmëria e çmimeve. Në një botë gjithnjë e më të ndërvarur dhe të ndryshueshme, koncepti i sigurisë së energjisë duhet ndryshuar dhe plotësuar edhe në legjislacionin tonë të brendshëm.

Kosova nuk e ka të rregulluar mirë kornizën ligjore që definon sigurinë e energjisë dhe që ndërmerr hapa konkret në adresimin e saj. Në njërin anë, siguria kufizohet në vetëm sigurinë e furnizimit e në anën tjetër, nuk përfshihen fare elementet e mbrojtjes së konsumatorit siç janë cilësia e furnizimit dhe përballueshmëria e çmimeve.

Siguria e furnizimit në Kosovë është e trajtuar pothuaj ekskluzivisht përmes projektimit të një termocentrali të ri me qymyr. Ajo është projektuar duke marrë për bazë realitetin e tanishëm të një sistemi energjetic të pa integruar dhe që ende nuk i është ekspozuar hapjes së mirëfilltë. Koncepti i sigurisë së energjisë dhe sigurisë së furnizimit në veçanti është dukshëm më i ndryshëm në një realitet të një tregu të integruar.

---

<sup>12</sup> KOSTT(2019), Operimi i Sistemit Energjetic, Prishtinë: Ueb faqja e KOSTT.

Qeverisë dhe institucioneve të Kosovës u mungojnë qëndrime konsistente në lidhje me tema që ndërlidhen me sigurinë e energjisë. Siç u pa nga punimi, dy qëndrime të ndryshme të të njëjtit institucion përshkruajnë adekuacinë e sistemit dhe adekuacinë e gjenerimit në Kosovë. Kjo si rrjedhojë e ndikimit politik në vendimet për sektorin e energjisë dhe në institucione rregullatore siç është Zyra e Rregullatorit për Energji.

Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm të rritjes së sigurisë së furnizimit integritet të Kosovës në tregun rajonal. Në nivel të sistemit të transmisionit, Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm të ndërlidhjet me vendet në rajon si dhe kapacitet shumë të lartë të rrjetit për qarkullim të energjisë. Vendimi i fundit i ENTSO-E ka bërë që së shpejti të hapet rruga për më tepër integrim të rrjetit.

Kosova me Shqipërinë kanë shansin të krijojnë një bursë të përbashkët energjetike si dhe një treg të përbashkët të energjisë. Ky bashkim energjetik do të ishte hapi i parë drejt krijimit të tregut të integruar rajonal. Tregu i përbashkët Kosovë-Shqipëri do të jetë i një rëndësie të veçantë sidomos për faktin se do të ketë më shumë shkëmbim të energjisë dhe do të ketë ndarje të rezervës terciare të energjisë.

Tregu i integruar rajonal i energjisë është një faktorë shtesë që do të ndikoj në rritjen e sigurisë së energjisë. Kosova duhet që menjëherë të bëjë përgatitjet e duhura për këtë proces duke krijuar mekanizma që do të sigurojnë liberalizimin e tregut të brendshëm dhe rritjen e besimit për bashkëpunim me vendet e rajonit.

## **Rekomandime**

Qeveria e Kosovës duhet të definoj drejtë sigurinë e energjisë në legjislacionin aktual dhe në politikbërjen në fushën e energjisë. Investimet që rrisin koston për qytetarët përtej përballueshmërisë dhe që thellojnë varfërinë energjetike duhet të ndalen. Po të jenë parasysh të drejtat e konsumatorëve dhe përballueshmëria e çmimeve, Kosova do të zhvilloj politika që rrisin sigurinë energjetike krahas mbrojtjes së të drejtave konsumatore.

Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të ndaloj së miratuari taksën për Obligimin e Shërbimit Publik për siguri të furnizimit. Siguria e furnizimi është e drejtë e konsumatorëve dhe si e tillë, për të nuk mund të paguhet një taksë shtesë. Siguria e energjisë hynë brenda konceptit të sigurisë së përgjithshme. Kështu, është obligim i shtetit që kjo të ofrohet dhe jo që qytetarët të paguajnë taksë. Siguria është e drejtë e jo shërbim!

Qeveria e Kosovës duhet të fokusohet në masa të rritjes së menaxhimit të energjisë. Kjo do të kontrollojë kërkesën për energji dhe do të rrisë aftësitë e sistemit për më shumë prodhim nga burime të ripërtrishme dhe më pak varshmëri nga importi.

Qeveria e Kosovës duhet të investoj në kapacitete të reja të depozitimit të energjisë. Bateritë do të jenë të domosdoshme për tranzicionin energjetik. Duke qenë se Kosova ka kapacitete të konsiderueshme interkonektive, kjo do ta bëjë Kosovën më pak të varur nga importi dhe një akter të rëndësishëm në rrjedhat e energjisë në rajon.

KOSTT duhet të fokusohet në rritjen e kapaciteteve interkonektive. Kjo do të mundësoj rritjen e transaksioneve me rajonin tani kur më në fund, KOSTT po bëhet zonë rregulluese në Kosovë. Kjo do të pozicionoj Kosovën në një akter të rëndësishëm rajonal.

Duhet rritur nxitja për investime në burime të ripërtrishme. Prodhimi në vend duhet rritur për të mbuluar kërkesat për energji gjithnjë e në rritje. E vetmja rrugë për të arritur këtë është përmes investimeve në burime të ripërtrishme. Kosova duhet të zhvilloj një One Stop Shop dhe të rishikoj procedurat e autorizimeve.

Konsumatorët me vet-konsum duhet të fuqizohen. Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të sigurohet se kompanitë në treg e sidomos furnizuesit dhe Operator i Sistemit të Shpërndarjes janë duke e zbatuar Rregulloren për Skemën Mbështetëse. Vetëm 3 licenca për vet-konsum janë një numër tejet i vogël dhe kjo është një dështim i zbatimit të kësaj rregulloreje. Skema duhet rishikuar gjithashtu në atë mënyrë që të ndryshohet kufiri i lejuar i kapacitetit, kompensimi i balanceve positive dhe procedurat teknike për kyçje në rrjet.

Bashkimi energjetik me Shqipërinë duhet të jetë prioritet i Kosovës. Ky proces duhet t'i paraprijë një integrimi në tregun rajonal të energjisë, i domosdoshëm për tranzicionin energjetik. Kosova ka mundësinë unike që duke bashkuar tregun me Shqipërinë të përfitoj nga kosto më të ulta të tregut të kapaciteteve dhe të rritjes së sigurisë. Kjo do të realizohet përmes bashkimit të kapaciteteve të rezervave terciare në rajon, të atilla që mundësojnë kosto shumë më të ulta për shtetet si dhe nevojë më të vogël për kapacitete shtesë.

Siguria e energjisë duhet përfshirë në të gjitha dokumentet strategjike dhe prioritetet politike. Në vend të qasjes një-dimensionale për ndërtimin me çdo kusht të kapaciteteve të reja me qymyr, institucionet e Kosovës duhet të fokusohen në një strategji shumëdimensionale duke ruajtur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe synimin për tranzicion të energjisë. Të gjitha së bashku, do të ndikojnë që siguria e energjisë si e drejtë të realizohet edhe pa qymyr.